



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE  
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 13134/3

Vlorë, më: 30.10 2023

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM

Datë: 10.10.2023 Ora: 17: 00

**Tema: Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë**

**Baza Ligjore:** Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Urdhrit nr.11769 datë 4.10.2023.

**Marrin pjesë:**

*Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak- znj.Elpinqi Mërkuri, Kryetari i Njesisë Administrative Orikum –Selim Haskocelaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj, Drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, drejtori i buxhetit dhe financës, sektori i tatim taksave kryetarë të fshatrave të Njesisë Administrative Orikum, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media dhe OJF locale.*

*(Në takim marrën pjesë më shumë se 31 persona, listeprezenca bashkangjitur)*

...in e hapi Kryetari i Njesisë Administrative Orikum-Selim Haskocelaj-Përshëndetje të  
ve dhe ju falenderoj që jeni pjesë e takimit. Për shkak të një vonese të kryetarit të bashkisë  
cel unë takimin. Ky takim është për të diskutuar për buxhetin e planifikuar për vitin 2024  
është në vijim të takimeve nëpër fshtatra ku së bashku kemi diskutuar mbi problematikat dhe  
tësimet që keni. Ajo që NE duam është që kërkesat tona të na i kthejnë në investime. Po ja  
ajalën Kryetares së Këshillit.

...iniqi Mërkuri-Kryetare e Këshillit Bashkiak- Përshëndetje dhe afleminderit që jeni pjesë  
takimin që ne po vijojme për konsultimin e draft buxhetit për vitin 2024\ . Faleminderit për  
rimin që keni treguar dhe jam e bindur që në 4 vitet e ardhshme do të kemi më shumë  
shkëpunim. Projektet dhe investimet do të jenë ne fokusin tonë.



### Degjesa per Projektbuxhetin 2024 Njesia Administrative Orikum

Për më shumë konsultoni linkun

<https://fb.watch/nCCHTyPPjO/?mibextid=Iprqdp>

**Hiqmet Haxhaj Drejtor i Financës në Bashkinë Vlorë** – Prezanton ligjshmërinë e takimit për të konsultuar projektbuxhetin e bashkisë Vlorë për vitin 2024 si dhe për planifikimin e buxhetit afatmesëm 2024-2026 I cili bazohet në Udhëzimin e Ministrisë së Financave,. Është hartuar projektbuxheti sipas programve të miratuara nga këshilli bashkiak dhe do të diskutohet me grupet e interesit në secilën njësi të bashkisë Vlorë. Të ardhurat dhe shpenzimet janë parashikuar sipas prioritetit të Planit të Përgjithshëm Vendor 2021-2031 të Bashkisë Vlorë në fushën e turizmit, zhvillimit ekonomik, punësimit, transportit, sipërmarrjes sociale, cilësisë së jetës dhe kohezionit social.

Të ardhurat totale për vitin 2024-2,659.506 mije leke (2 Miliard...)

Grant I pakushtëzuar nga qeveria : 710.738 mijë

Viti 2023 rreth 674 milion lek

Viti 2024 ka një rritje 6% - rreth 710 milion lek

Viti 2025 rreth 748 milion lek

Viti 2026 rreth 788 milion lek

Grant specifik:

Viti 2024- 447.452 milion lek

Shpenzimet e parashikuara për vitin 2024 për Bashkinë Vlorë janë parashikuar 608 milion.. në sektorët e pyjeve dhe kullotave, rrjeti rrugor, shërbime publike vendore, shërbime sportive, trashëgimi kulturore, arsimi i mesëm.

Në plan afatmesëm ne vitin 2026 janë parashikuar të ardhura total në vlerën 2 miliard 759 milion lek. Të cilat behen nga te transferta të pakushtëzuara

Në Njësinë Orikum investimet e parashikuara në buxhetine vitit 2024 janë për 38 milion përfshirë:

Rikonstruksionin i rrugës në Lagjen Kodër, Orikum

Rruga Orikum – Pisha

Ruga për te Kisha e Marmiroit

Shëtitörja e Tragjasit. Në total-430 milion lekë/vjetra, pa përfshië investimet në shkolla.

Për sektorin e arsimit do të shpenzohen 250 milion lek në shkollat e arsimit 9 vjecar dhe të mesëm.

**Mezin Ramohitaj-Kryetar i fshatit Tragjas** – Zona ka qënë jashtë vëmendjes së bashkisë. Këto prioritete kanë qënë dhe duhen të realizohen. Tragjasi ka rritje të numrit të bizneseve në zonë. Rruga “Zonja Cure” dhe rrugën “Neim Dano” duhet të rregullohet po ashtu dhe Bulevardi në Tragjas ska ndricim.. Ne kemi bërë pjesën tonë ppr duhet edhe nga ju. Ndërhyrjet në kanalizime janë problem. Loti III rruga e Tragjasit. Më shumë se 70% e fshatit pa rrugë, dhe ato që janë janë të amortizuara, nga projekti I ujësjellësit-kanalizime. Paguajmë taksat.

**Meladin Sulo-Tragjas** – Para 5 muajve keni ardhur dhe keni bërë fushatën me ne. Sot na ke mbledhur për problemet tona.Faleminderit. Nuk na harrove. Problemet të menaxhohen sipas rasteve. Për Tragjasin janë parashikuar 43 mil lek të reja. Rruga në Tragjas është matur shumë herë. Mbeturinat janë në rrugë.

**Arsen Bellaj-Anëtar i Këshillit Bashkiak-** Të ardhurat për shpenzimet dhe investimet, çfarë u bë vjet? E dimë sa investime u bënë në 2023. Projektbuxheti I Orikumit ka shumë për të bërë:

Ska drita, si do zhvillohet turizmi?

Mbeturinat, janë problem madhor.

Të ketë shpërndarje faktike për Orikumin. Fshatrat e Radhimes dhe Dukat Fushë të shikohen me prioritet.

**(Vjen)Ermal Dredha-Kryetar i Bashkisë Vlorë.** Përshëndetje dhe ndjesë për vonesën. Do të vazhdojmë me misionin që kemi nisur. Do bëjmë dëgjesat dhe të realizojmë punët tona. Disa nga investimet janë të Qeverisë Shqiptare.

Rruga e fshatit Radhimë, Kopshti 430 milion lekë do të segmentohet

Projekti për rrugët e brendshme të Orikumt.

Jemi të kenaqur? Smund ta them. Ka shumë projekte nga qeveria. Sot gjendja ka ndrsyhuar. Do të ketë investime në infrsaturë. Loti III Tynel-Radhimë. Do bëhen shpronësimet. Do shohim më të mirën për komunitetin. Do të shikojmë Tragjasin, Radhimën. Për Orikumin janë investime që do bëhen sepse zona ka marrë zhvillim. Infratsruktura dhe investimet publike. Buxheti i parashikuar do realizohet, Zhvillimi i qytetit ka ardhur edhe nga investimet dhe permiresimet në infrastrukurë që janë investuar nga buxheti i bashkisë. Në Dukat fshat do bëhet rruga jo me buxhetin e bashkisë, por do kontaktojmë me ARSH. Investimet strategjike të Qeverisë / By Pass Radhimë do sjell zhvillimin e zonës.



**Dëgjesa per Projektbuxhetin 2024  
Njesia Administrative Orikum**

**Lefter Leka-Orikum.** Është punuar me pastrimin e qytetit. Kam një problem. Në vitin 2002 kam marr dok e shtëpisë dhe hartën. Sot nga zhvillimi rrezikohet toka dhe 2 shtëpitë që kam nga shkitjet e dheut dhe ujrat në kodër të Orikumit. Kërkoj të ndërtohet muri që të parandaloj rrezikun e shembjes.

Foto Gjipali-Kemi kanal në mes të fshatit, shkollën..nuk është investuar për asgjë.

**Muharrem Jazaj-Dukat i Ri** - Situata sot është më mirë por ka probleme. Kam besim te ai projekt. Por rruga ka inerte të hedhura nga guroret. Të investohet në rrugët dytësore. Projekti i dytë u ndërpre. Duhet filluar e mbaruar një projekt pastaj të filloj tjetri. Projekti i ujrave të zeza...shkatërron rrugën dhe ikin. Kush i kontrollon nga ana e bashkisë?

**Selim Haskocelaj-Kryetari i Nj.Adm.Orikum**-Uji i pijshëm, FSHZH ka investuar per Tragjasin dhe Orikumin miliona euro. Mbaruan këtu dhe vazhdojnë me procesin tjetër 50 mil euro për ujësjellësin.

**Arsen Bellaj- Anëtar i Këshillit Bashkiak** -Të flasim për problemet që kemi. Dukati, fshat Dukat, radhimë...

**Valter Hasanaj-Radhimë.** Rruga në Radhimë është bërë dhe shkatërruar shumë herë. Ët ketë vëmendje. Sezoni turistik ka sjellë probleme me trafikun, parkimin, hotelerinë, transportin për taksitë dhe autobusët. Nuk do investim të madh por do vëmendjen tuaj për menaxhimin e problemeve. Orikumi do ndricim. Rruga në Radhimë ka ngelur 100 metra te varrezat.

**Aziz Kapaj-Orikum.** Problemet që dua të parashtoj janë; rrugët si prioritet dhe shëtitorja e Tragjasit, pastrimi i hapësirave publike midis pallateve dhe lagjeve, Kisha e Marmiroit, pastrimi i kanaleve do të ndihmonte shumë. Ne i pastrojme edhe vete por ndihma juaj do ishte në dobi të fermerëve.



**Degjesa per Projektbuxhetin 2024  
Njesia Administrative Orikum**

**Sherif Dyrmishi- Radhimë.-** Kisha e Marmiroit është me shumë interes. Po ashtu edhe sporti. Bizneset duhet të paguajnë dhe të ndihmojnë shtetin. Radhima është një segment që lidh aksin rrugor kryesor dhe fshati është i mrekullueshëm. Bujqit kanë bërë ndërtime të pa kontrolluara.

**Arsen Bellaj- Anëtar i Këshillit Bashkiak**-Të vihet dorë në rrugët e fshatrave. 500 metra rrugë që shkon deri në det. Shkolla e mesme në Dukat dhe Orikum është turp. Duhet rikonstruktuar, Shkollat po boshatisen.

**Ermal Dredha –Kryetar i Bashkisë Vlorë-** Më vjen keq që shikoj vetëm Arsenin këtu. Administrata e bashkisë është e pranishme sepse e ka detyrim ligjor të konsultoj buxhetin me grupet e interesit. Prandaj jemi këtu që komuniteti të parashtoj shqetësimet në fazën e projektbuxhetit dhe të bëjmë çtë mundim për ti realizuar. Këtu është prezent edhe Arjona e MIM. Sot firmosa projektin e Landfillit, është për të mirën e komunitetit.

Ju falenderoj që ishit prezent në takim!

**Konceptoi:** Albana Naçi

**Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**